REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr.2503 Prot Vlorë, më 29.09.2026

VENDIM

Nr. 15, datë 25.09.2026

PROPOZIM PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR PËR Z. GËZIM HETEM ZENELI

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 25.09.2026 në mbështetje të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pikës 4 dhe 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar si dhe kërkesës së Z. Gëzim Hetem Zeneli për përfitim shtese pensioni të posaçëm shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 1959 Prot, datë 28.07.2026 ,

VENDOSI;

3. T`i propozojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhënien e shtesës së Pensionit të Posaçëm Shtetëror Zotit Gëzim Hetem Zeneli, për veprimtarinë e tij shumëvjeçare, punën e tij të palodhur ndër vite, kontributin e çmuar në sportin e boksit si trajner i Ekipit "Flamurtari" dhe atij "Kombëtar".

4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social/Sektori i Ligjshmërisë, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit në Këshillin e Qarkut Vlorë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë!

KRYETARI

Ervis Moçka

(nënshkruar dhe vulosur)

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.____Prot, datë ____.____.2026.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

Të Nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe pikës 4 e 5 të VKM - së Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, kanë të drejtë për pensione të posaçme që jepen nga shteti personat që:

a) Kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazifashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta;
b) Kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës;
c) Kanë vuajtur nga persekutimi politik nën regjimin komunist.

Pensionin e Posaçëm Shtetëror e përfitojnë personat të cilët përmbushin kushtet e sipërpërmendura si shtesë mbi pensionin që u takon nga Sigurimet Shoqërore, ose si pension nëse nuk përfitojnë pension nga Sigurimet Shoqërore.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur Z. Gëzim Hetem Zeneli, i lindur më [redacted] Vlorë, dhe banues në Vlorë, ka paraqitur kërkesë pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë për përfitim shtesë Pensioni të Posaçëm Shtetëror, protokolluar me tonën Nr. 1959 Prot, datë 28.07.2026, kërkesë e cila është mbështetur edhe nga Federata Shqiptare e Boksit me shkresën Nr. 56 Prot, datë 10.07.2026 me lëndë "Vërtetim" dhe nga Bashkia Vlorë/Klubi Shumësportësh Flamurtari me shkresën Nr. 71 Prot, datë 23.07.2026 me lëndë "Vërtetim".

Kërkesa drejtuar institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë mbështetet në punën e palodhur shumëvjeçare, profesionalizmin, integritetin dhe përkushtimin në edukimin e sportistëve duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e sportit të boksit dhe në afirmimin e vlerave më të mira sportive.

Z. Gëzim Zeneli është një nga figurat më përfaqësuese të boksit vlonjat dhe shqiptar, me mbi 35 vjet angazhim në formimin e sportistëve dhe zhvillimin e kësaj disipline. I lidhur me sportin, atletikën e mundjen që në rini, ai iu rikthye plotësisht boksit pas lejimit të ushtrimit të tij në Shqipëri, duke u bërë një nga nismëtarët dhe drejtuesit kryesorë të ringritjes së boksit në Vlorë dhe duke shndërruar ekipin e "Flamurtarit" në një nga qendrat më të rëndësishme të boksit shqiptar.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail:info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

Gjatë karrierës së tij si trajner i ekipit të "Flamurtarit" dhe atij "Kombëtar" të boksit, ka kontribuar në formimin e dhjetëra kampionëve kombëtarë dhe sportistëve me rezultate të spikatura në kampionate evropiane, ballkanike, turne ndërkombëtare dhe Lojërat Mesdhetare. Në drejtimin e tij, ekipi "Flamurtari" është shpallur disa herë kampion i Shqipërisë në grupmosha të ndryshme, si më poshtë :

- 10 (dhjetë) herë kampion i Shqipërisë për grupmoshat 12 - 14 vjeç;
- 9 (nëntë) herë kampion i Shqipërisë për grupmoshat 14 - 16 vjeç;
- 12 (dymbëdhjetë) herë kampion i Shqipërisë për grupmoshat 16 - 18 vjeç;
- 3 (tre) herë kampion i Shqipërisë për të rritur;
- 12 (dymbëdhjetë) herë fitues i Kupës së Shqipërisë.

Përkushtimi, pasioni dhe profesionalizmi i tij i palëkundur kanë shërbyer si një model frymëzimi për brezat e rinj. Nëpërmjet punës së tij të vazhdueshme dhe vizionit të qartë, trajneri Zeneli ka arritur të formojë sportistë cilësorë, duke ndërtuar jo vetëm kampionë, por edhe individë me karakter të fortë, me disiplinë dhe shpirt garues.

Nën drejtimin e tij, sukseseve të arritura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është lartësuar sporti i boksit duke përfaqësuar me dinjitet vlerat Olimpike.

Bashkëlidhur kërkesës/propozimit gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- Jetëshkrimi (CV);
- Çertifikatë personale, me datë 21.07.2026;
- Çertifikatë familjare, me datë 21.07.2026;
- Fotokopje letërnjoftimi elektronik;
-Vërtetim për lloj dhe masë pensioni nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, datë 08.07.2026;
- Kopje e noterizuar e Çertifikatës Nr. 47, datë 05.06.2015 "Për Punonjës Shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike" nga Ministria e Punëve të Brendshme;
- Kopje e noterizuar e Çertifikatës si "Operator" nga Arms School Academy, datë 05.04.2019;
- Kopje e noterizuar e Autorizimit nga Bashkia Vlorë/Klubi Shumësportësh Flamurtari për përfaqësim në Federatën Kombëtare të Boksit;
- Kopje e noterizuar e Titullit "Mjeshtër i Madh" dhënë nga Presidenti i Republikës me Nr. Dekreti 10537, datë 27.06.2017 me motivacion "Për veprimtarinë e tij të çmuar dhe me mirënjohje ndaj punës së tij të palodhur ndër vite, duke kontribuar ndjeshëm për sportin e boksit, si trajner i Ekipit "Flamurtari" dhe atij "Kombëtar".

- Kopje e noterizuar e Çertifikatës "Për Punonjës Shërbimi Privat të Sigurisë Fizike;
- Kopje e noterizuar e Çertifikës së Trajnimit nga Regjistri Detar Shqiptar, datë 21.03.2008;
- Kopje e noterizuar e Diplomës së Universitetit Teknologjik "Ismail Qemal Vlora" në Degën "Turizëm", datë 15.07.2002;
- Kopje e noterizuar e Titullit "Mirënjohje" nga Klubi i Boksit "Gollaku" Boxing Club, në Turneun e 5-të Memorial Ndërkombëtar të Boksit "Ismet Asllani - Prapashtica", Prishtinë, 2019;
- Kopje e noterizuar e shkresës Nr. 56 Prot, datë 10.07.2026 nga Federata Shqiptare e Boksit me lëndë "Vërtetim";
- Kopje e noterizuar e librezës së punës;
- Kopje e noterizuar e titullit "Urdhëri Olimpik" dhënë nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar me motivacion "Për kontributin e çmuar në zhvillimin e sportit dhe promovimin e lëvizjes Olimpike në Shqipëri";
- Kopje e noterizuar e shkresës Nr. 71 Prot, datë 23.07.2026 nga Bashkia Vlorë/Klubi Shumësportësh Flamurtari me lëndë "Vërtetim";

Duke u bazuar në kërkesën e z. Gëzim Zeneli, në zbatim të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të pikës 4 dhe 5 të VKM- së Nr. 429 datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore" i ndryshuar, mendojmë se personi i propozuar plotëson kushtet për të përfituar këtë lloj pensioni.

Specialist/Jurist

Alma Myrtaj *(nënshkruar)*

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail:info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600